



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur me datë 17.01.2019 me fillim në ora 10.15, këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete mbledhjes z. Bajram Morina. Kryesuesi – Përshëndetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi, përshëndetje për Udhëheqësin e ZKK-së z. Lendrit Qeli, i dëshiroj suksese në këtë pozitë, përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK-ut, SHL- Kosova, juve anëtarë të Komitetit për Komunitet dhe të gjithë të pranishmit. Pasiqë është takimi i parë për vitin 2019, ju dëshiroj suksese në punë. Konstatoj se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

### REND DITE

-III- Nr. I prot. 368 Më 01.02.2019  
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar,
2. Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në lagjen e komuniteteve në fshatin Ratkoc,
3. Të ndryshme.

**Kryesuesi** – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhje e kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në aprovim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

#### 2. Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në lagjen e komuniteteve në fshatin Ratkoc.

**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para se të kaloj në diskutim rreth pikës së dytë të rendit të ditës, desha të diskutoj rreth pikave që i kemi pasur në mbledhjet e viti të kaluar. Ka qenë një pikë ku e kemi formuar komisionin i cili ka pas për detyrë të dele nëpër shkolla ku janë të fokusuar më së shumti komunitetet, ky komision nuk ka qenë funksional, pastaj një pikë ka qenë Rregullimi i bibliotekës në fshatin Ratkoc, pyetje ime është: A kanë gjete zbatueshmëri këto pika tek Kryetari i Komunës, në cilën fazë janë tani etj. Nuk më duket e arsyeshme që të diskutoj rreth pikës së dytë të rendit të ditës sot që e kemi, pa e mare një informatë se në cilën fazë janë këto pika që i ceka më parë, nëse ne debatojmë rreth kësaj pika pa u ditë se çka u bërë me pikat e para. Pastaj zakonisht Komiteti për Komunitete mendoj se duhet të ketë një Plan të punës për vitin 2019, i cili duhet të aprovohet në fillim të vitit pothuajse në të gjitha komunat, kurse tek ne jam duke parë që nuk ka kurrfarë plani të punës të këtij komiteti.

**Kryesuesi** – I nderuari z. Ali Zhuniqi sa i përket pikave nga viti i kaluar, disa i cekët ed ju, unë si Kryesues i Komitetit për Komunitete me anë të rekomandimit të dalë nga mbledhjet e këtij komiteti, ju kam drejtuar kryetarin me kërkesë sa i përket pikave që i përmendte ju por ende nuk kamë mare ndonjë përgjigje nga Kryetari. Kurse sa i përket përpilimit të Planit të Punës për vitin 2019, besoj se në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e K. Komunitete dhe me anë të OSBE-së, do të blejmë një plan ku do ti prefshim ato pika të cilat janë më me prioritet për komunitetet në përgjithësi të cilët jetojnë në komunën tonë. Pastaj duhet të bëjmë një raporte për punën e vitit të kaluar ku do të shikojmë pastaj se ato pika që i kemi shtjelluar vitin e kaluar sa kanë gjete zbatim dhe cilat pika nuk kanë gjetur zbatim.

**Ali Zhuniqi** – Sa i përket destinimit në vendin e duhur, ne të gjithë së bashku i kemi bashkërenduar në aspektin e planit ku pastaj kemi mare vendim që këto projekt të shtyhen përpara karshi interesave të komunitetit, prandaj nuk mendoj se ti duhesh tani të vësh në mëdyshje votimin e dy pikave paraprake të viti të kaluar, me këtë qëndrim ti e vure ne pah mëdyshjen tënde. Mendoj se pikat që jemi duke i diskutuar nga viti i kaluar kanë qenë shumë mirë të destinuara, por ju është dashur të keni takime më të shpeshta me instancat më të larta dhe të na tregosh pse këto nuk kanë ndodhur. Sa i përket Planit të punës për vitin 2019 ne jemi pro kësaj iniciative, por

pyetja ime është çka nëse ne e formojmë planin dhe ai nuk gjen zbatueshmëri, për vete nuk besoj se do të ketë ndonjë efektivitet me punën që ne vazhdimisht kemi me bërë.

**Mirjeta Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket takimeve që jemi duke i bërë, kisha kërkuar që këto vendime të gjejnë mbështetje tek ekzekutivi. Ne si Komitet për komunitetet kemi kërkuar nga ekzekutivi të bëhet ofrimi emergjent i ndihmës momentale familjeve në nevojë gjatë se zonës dimërore, pyetje ime është: Sa keni arritur ju si ekzekutiv të i dilni në ndihmë këtyre familjeve në nevojë. Pastaj pika tjetër ishte Krijimi i sallës së leximit në fshatin Ratkoc, pasi që mjetet veç ishin, edhe për këtë ju pyes sa ka gjetur zbatim kjo tek ekzekutivi. Kishte me qenë mirë që të kemi më shumë bashkëpunim me ekzekutivin e komunës, përndryshe nuk jam duke e parë shumë frytdhënës punën e këtij Komiteti. Kurse sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës që e kemi për sot, kërkoj më shumë informata nga ju Kryesues, na tregoni se ku ndodhet saktë kjo lagje, pastaj si është gjendja aktuale, pastaj e keni mbështetje nga ekzekutivi, apo ndoshta kjo lagje është e përfshirë në ndonjë projekt të paraparë për vitin 2019.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, së pari ju dëshiroj punë të mbarë dhe shumë suksese në vitin 2019. Besoj se në vitin 2019 punët do të mjerën me më shumë seriozitet, në vitin që e lëmë pas kemi diktuar ne si anëtar të K. Komunitete për shumë probleme dhe shqetësime që i kemi ne si komunitete, dosa nga kë[to shqetësime janë realizuar disa kanë mbetur ende pa u realizuar, por shpresoj se në këtë vite do të realizohen. U përmenden disa projekte si ai në Ratkoc për bibliotekë, siç e dimë ai projekt është pak i kushtueshëm dhe mendoj se nuk është aq urgjent që ai të realizohet, mendoj se duhet të investohet nga pak në të gjitha fshatrat ku jetojnë komunitetet jo shumicë. Sa i përket komisionit të formuar nga ky komitet për dalje në teren, mendimi imë është që këto vizita kishte me qenë më mirë të kryej DKA-ja.

**Ali Zhuniqi** – Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës dhe pikave të kaluara është interesante pse të gjitha pikat ose kërkesat je duke i drejtuar për fshatin Ratkoc, i nderuar nuk jetojnë komunitetet pakicë vetëm në fshatin Ratkoc, kjo na lënë të dyshojmë se Kryetari i Komunës dëshiron që Ratkocin të bëjë kryeqytet të bujqësisë. Me të vërtetë nëse dëshirojmë të punojmë seriozisht të ulemi në bashkëpunim me OSBE-në ta bëjmë në plan të punës për vitin 2019, dhe ashtu siç e cekim edhe z. Ramë Berisha të i mbështesim të gjitha komunitetet nga pak dhe jo i gjithë investimi të shkojë vetëm në një fshat.

**Kryesuesi** – I nderuari z. Ali Zhuniqi dua të bëjë një sqarim pse e kam futë si pikë të rendit të ditës për mbledhje të sodit pikën e dytë, është një lagje e re ku jetojnë shumica e anëtarëve të komuniteteve jo shumicë, ka edhe komuniteti shumicë, dhe kjo lagje nuk ka kurrfarë infrastrukturë të rregulluar, dhe më kanë ardhur kërkesa nga banorët e kësaj lagje se në kohën e pranverës dhe verës aty fillon të kundërmojë një erë e keqe, dhe aty afër është edhe shkolla fillore. Kjo ka qenë e vetme arsye pse e kam futur si pikë të rendit asgjë nuk e kam pasur me fshatin Ratkocë.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime për këtë Komitet është a e ka një plan të punës për vitin 2019, pra të dimë se cilat tema do të diskutohen në këtë vit, këtë plan duhet ta hartojë kryesuesi i Komitetit për Komunitete e jo Kryesuesi i Kuvendit siç e tha i nderuari z. Ali Zhuniqi se pikat i propozon kryesuesi i Kuvendit. Do ju japë disa sqarim sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës, sa i përket drejtorisë që unë e drejtoj nuk do të ketë dallime sa i përket investimeve, pra nuk do të bëhet dallimi sipas banimit të komuniteteve, investime do të bëjmë për të gjithë, ju kisha lutur që të gjitha kërkesat që dalin nga ky komitet që i takojnë drejtorisë që unë e drejtoj të protokollohen dhe të adresohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pastaj ne së bashku me inxhinierët e komunës do ti adresojmë këtë kërkesa pasi që është fillimi i vitit dhe ne planifikimin projekteve e bëjmë në fillim të vitit. Në për vitin 2019 e kemi futur në planifikim ndërtimin e trotuareve në fshatin Ratkoc në pjesën ku jeton komuniteti jo shumicë edhe pse neve nuk na ka ardhur kurrfarë kërkesë nga ky komitet, po ashtu pasi që të përmirësohet koha do të fillojë trajtimi i kanalizimeve në shumë lagje në fshatin Ratkoc, po ashtu edhe ndriçimi publik në rrugën kryesore do të vendoset. Prandaj të nderuar kërkoj nga ju që të vini në zyrën time të sillni kërkesat e juaja në mënyrë që ne bashkërisht me ju të i trajtojmë të gjitha çështjet që ngritën si në këtë komitet po ashtu edhe jashtë këtij komiteti nga banorët e ndryshëm. Përveç kësaj ne jemi mare edhe me komunitetin jo shumicë i cili jeton në Krushe të Madhe, pastaj në lagjen e epërme të Rahovecit, këtë vit do të trajtohen dy tema të mëdha për këtë vendbanime siç është ndriçimi publik, si dhe nderimi i kontejnerëve të mbeturinave sepse disa nga ta janë të dëmtuara, ne si komunë e kemi fituar grandin për kontejnerë diku rreth 500 kontejnerë. Po ashtu edhe në fshatin Xërxë në lagjen e komuniteteve e kemi trajtuar një

projekt të kanaleve të ujërave atmosferik, implementimi ka filluar në tetor të viti 2018 dhe është duke vazhduar edhe këtë vit.

**Darko Antiq** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, sa i përket borës e cila ka rënë këto ditë, pastrimi i rrugëve si në lagjen e epërme të Rahovecit, ashtu edhe në fshatin Hoçë e Madhe është duke u bërë me vonesë, kishte me qenë mirë që pastrimi i rrugëve të bëhet pak më shpesh, sepse janë duke u krijuar probleme serioze për arsye se nuk po mundemi të lëvizim.

**Përparim Krasniqi** – Është e vërtet dhe siç e dini reshje të borës ka pasur shumë, po ashtu është e vërtet që ka pasur vonesa në tre vendbanime si në Hoçë të Madhe, Zoqishtë dhe Opterush, arsyeja ka qenë për shkak të pjerrtësisë të madhe të rrugës dhe ndoshta me kohë nuk kemi mundur që të shkojmë, por besoj se ne kemi arritur që të përballojmë këtë gjendje sepse ka pasur reshje të mëdha. Këtë porosi do ja përcjelli Drejtorit për Emergjencë sepse ai tani e menaxhon këtë kontratë.

**Kryesuesi** – E përshëndes edhe një herë shefin e ri të ZKK-së z. Lendrit Qeli të cilit i dëshiroj punë të mbarë në këtë detyrë, besoj që do të kemi një bashkëpunim të mirë ne si komitet me këtë zyre, fjala është e juaj i nderuar.

**Lendrit Qeli** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ashtu siç me prezantoi edhe Kryesuesi i Komitetit për Komunitete që nga janari i këtij viti e kam marrë detyrën e shefit të ZKK-së, një zare e cila për mua por besoj edhe për të gjithë të tjerët konsiderohet një zyre sensitive, sepse në momentin e parë që bisedohet për komunitetet gjithmonë barra i shkon ZKK-së. Duke marrë parasysh se kjo zyre pothuajse që katër vite ka qenë pa udhëheqës të zyrës dhe dihet se deri diku ndoshta problemet e komuniteteve nuk janë trajtuar në mënyrën e duhur, përkundër faktit që besoj se komuna i ka trajtuar përmes mekanizmave tjerë të cilat e përfaqësojnë të drejtat e komuniteteve duke përfshi këtu Komitetin për Komunitete. Ajo që mua më takon është ndoshta krijimi i një jete më të mirë për pjesën e komunitetit jo shumicë, ju besoj se i keni informatat por unë jam këtu për të ju njoftuar. Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete e ke një fond të limituar, kjo ndoshta për arsye të mungesës së planifikimit të mëhershëm, ndoshta edhe për arsye të mungesës së udhëheqësit të zyrës, shuma prej 61,000.00 € shkon për paga dhe mëditje, shuma prej 24,500.00 € shkon për mallra dhe shërbime dhe vetëm 30,000.00 € janë për investime kapitale, në brendësinë e këtij buxheti përfshihet edhe Hoça e Madhe. Ne si zyre me këto mjete shpresojmë se do të bëjmë ndërtimin e disa shtëpive ose të paktën renovimin e tyre ose disa projekte të cilat prekin infrastrukturën. Jam duke provuar çdo ditë që të kontaktoj donator të tjerë të cilët kishin mundur të na ndihmojnë në bashkëfinancim në projekte të ndryshme, do i ceki disa fusha ku mendoj se duhet të intervenohet urgjent në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve. Së pari ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturën ligjore që në këtë rast Komuna e Rahovecit është me vonesë sa i përket hartimit të Planit të Veprimit për Komunitete Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Paraprakisht desha të ju them se akronimi RAE nuk pranohet të thuhet sepse është antikushtetuese, por duhet të trajtohen si tre komunitete të veçanta sepse ashtu i njih Kushtetuta, është njëjtë nëse i përziejmë komunitetin Turk dhe Boshnjak e qo duhet të i quajmë komuniteti turbo, të mos keqkuptohem por e them sepse duhet që të raportohet për secilin komunitet veç e veç se si është gjendja me vetë faktin se i përfaqësojmë të gjitha komunitetet e sidomos komunitetet që jetojnë në Komunën e Rahovecit. Duke u batuar në funksionin që e ka kjo zyre ne si prioritet do i japim edhe të kthyerve, posaçërisht atyre që janë të rajonit dhe të riatdhesuarve nga diaspora, ne gjithashtu jemi duke punuar në identifikimin e problemeve sociale që ballafaqohen Komunitetet për kundër faktit që me buxhetin e trashëguar nuk kemi ndonjë linjë të posaçme që do të mundemi të i ndihmojmë personat me probleme sociale, por do të shohim mundësin me vullnetin e kryetarit që nga subvencionet që ai i ka të gjejmë hapësirë për ti ndihmuar këta komunitete sepse problematika kryesore që ata i preokupojnë janë problemet sociale. Sa i përket Planit të veprimit për Komunitete Romë, ashkali dhe Egjiptian që është rrjedhojë e strategjisë për mbështetjen e këtyre komuniteteve e që limiti i këtij plani është 2017-2021, kurse ne si komunë jemi me pak vonesë në këtë drejtim, por besoj se kjo duhet të ndodhë sa ma shpejtë sepse si rrjedhojë kësaj qeveria ka mundësi që të ndajë fonde shtesë për neve si zyre. Ne e kemi një shpresë sepse tre ministri kanë shprehur gatishmëri për ndërtimin ose renovimin e disa shtëpive, për këtë kam pasur dje një takim, do zoti që të gjejmë edhe forma të tjera edhe për tokë në mënyrë që familjet që kanë këso probleme të i gjejmë një zgjidhje më të përhershme.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit z. Lendrit Qela, kalojmë në pikën e fundit:

### 3. Të Ndryshme.

**Ramë Berisha** – Të gjitha takimet që jemi duke i mbajtur ne synimin kryesor e kemi që ti informojmë organet kompetente para se të vije deri tek ndonjë fatkeqësi, pra të behet parandalimi, në vitin që e lëmë pas e kam bërë

një kërkesë për rregullim të një rruge në fshatin Xërxë, në atë rrugë jetojnë të gjitha komunitetet, kjo rrugë nuk ka ndonjë distancë të madhe, por asgjë deri më tani nuk është bërë. Po a kam kërkuar edhe vendosjen e disa mbrojtësve anësore të një ure, këto mbrojtëse kanë qenë por janë hequr dhe ka rrezik që të bie ndonjë fëmijë edhe për këtë asgjë nuk është bërë, shpresoj se në këtë vite këto do të rregullohen në këtë vit.

**Ali Zhuniqi** – I nderuari kryesues cili është mendimi juaj sa i përket hartimit të një Plani të Veprimit pasi që tani është zgjedhur edhe Shefi i ZKK-së, në koordinim edhe me OSBE-në, pra cili është plani i juaj rreth kësaj.

**Kryesuesi** – I nderuar sa i përket Planit të Veprimit për vitin 2019 ne do të ulemi së bashku me të gjitha anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe me shefin e ZKK-së, do të hartojmë një plan të mirëfilltë. Me kaq e përfundoj takimin e sodit, ju faleminderit për pjesëmarrje shihemi në takimet e radhës.

Mbledhje ka përfunduar në ora 11:15

Procesmbajtësi,  
  
 Skender Hamza



Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina

